REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA - VLADA - GOVERNMENT
MINISTRIA E DIGJITALIZIMIT DHE ADMINISTRATËS PUBLIKE- MINISTARSTVO DIGITALIZACIJE I JAVNE UPRAVE - MINISTRY OF DIGITALIZATION AND PUBLIC ADMINISTRATION
Nr./Br./No 3405 Nr. I faq/Br.str/No.pg
Data/Datum/Date 23 / 11 / 2026
PRISHTINË - PRIŠTINA - PRISTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada -Government
Ministria e Digjitalizimit dhe Administratës Publike
Ministarstvo digitalizacije i javne uprave - Ministry of Digitalization and Public Administration

Kabineti i Ministrit – Kabinet ministra – Cabinet of the Minister

Nr.3405/2026
Datë: 23.11.2026

Ministri i Digjitalizimit dhe Administratës Publike, në mbështetje të nenit 10 dhe nenit 11 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare Nr. 07, 01 mars 2019), nenin 13 paragrafi 1 dhe 17 paragrafi 4 i Ligjit Nr.08/1-197 për Zyrtarët Publik, si dhe nenin 6 paragrafi 7 i Rregullore Nr. 03/2024 për Planifikimin e Personelit, nxjerr:

V E N D I M

1. Miratohet Plani i Përgjithshëm i Personelit për zyrtarët publikë të institucioneve të administratës shtetërore për vitin 2026.

2. Plani i personelit për institucionet e administratës shtetërore së bashku me planet e personelit të institucioneve tjera të miratuara nga titullarët e institucioneve, bëhet pjesë e Planit të Përgjithshëm të Personelit për zyrtarët publikë për vitin 2026 dhe i njëjti publikohet në ueb - faqen e MDAP-së.

3. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë (tani e tutje: DMZP) në Ministrin e Digjitalizimit dhe Administratës Publike(tani e tutje; MDAP), përmes SIMBNj-së ka pranuar planet e personelit për zyrtarët publikë të institucioneve të administratës shtetërore dhe institucioneve tjera. Planet e Personelit të institucioneve tjera, në përputhje me nenin 17 paragrafi 4 të Ligjit përkatës për Zyrtaret Publik, janë miratuar nga titullarët e institucioneve përkatëse.

Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë-DMZP, ka pranuar planet vjetore të personelit nga pesëdhjetë e një (51) institucionet të administratës shtetërore, të cilat në përputhje me LZP-në miratohen përmes këtij Vendimi.

Në anën tjetër, DMZP ka pranuar dyzet e shtatë (47) plane të personelit nga institucionet tjera të miratuara nga titullarët përkatës, nga të cilat dymbëdhjetë (12) plane nga institucionet e pavarura dhe tridhjetë e pesë (35) plane të personelit nga komunat, të cilat janë inkorporuar në planin e përgjithshëm të personelit për zyrtarët publikë për vitin 2026.

Pas konstatimit nga DMZP se plani i personelit është hartuar në pajtim me dispozita ligjore në fuqi, u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Lulëzon JAGXHIU

Ministri i Ministrisë së Digjitalizimit
dhe Administratës Publike

Vendimi i dërgohet:

- *Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm të MDAP-së;*
- *Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë;*
- *Arkivit të MDAP-së.*

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria / Vlada / Government
Ministria e Digjitalizimit dhe Administratës Publike – Ministarstvo digitalizacije i javne uprave – Ministry of Digitalization and Public Administration

PLANI I PËRGJITHSHËM I PERSONELIT PËR VITIN 2026

Tetor 2026

PËRMBAJTJA

1. Hyrje 5
2. Pozitat e lira në të gjitha institucionet 7
2.1 Krahasimi i pozitave të parapara për vitin 2026 me Planin e Personelit 2025 8
2.2 Profili arsimor i pozitave të lira të shërbimit civil dhe mënyra e përmbushjes së pozitave 9
3. Pozitat e lira në kuadër të Institucioneve të Administratës Shtetërore 10
3.1 Krahasimi i pozitave të parapara për vitin 2026 me Planin e Personelit 2025 për Institucionet e Administratës Shtetërore 13
4. Pozitat e lira në kuadër të Institucioneve dhe Agjencive të Pavarura 15
5. Pozitat e lira në kuadër të Komunave 16
6. Plani i Trajnimeve 18

Lista e Tabelave

Tabela 1. Vendet e lira në të gjitha institucionet sipas kategorive të zyrtarëve 7
Tabela 2. Numri i pozitave të lira për zyrtarët publik në të gjitha institucionet të ndarë sipas institucioneve dhe kategorive të zyrtarëve 8
Tabela 3. Nëpunësit e shërbimit civil në të gjitha institucionet sipas kategorisë 8
Tabela 4. Krahasimi i pozitave të lira 2025 dhe 2026 9
Tabela 5. Pozitat e lira të shërbimit civil në institucionet e administratës shtetërore sipas kategorisë së pozitës 11
Tabela 6. Pozitat e lira në institucionet e administratës shtetërore sipas kategorisë së zyrtarëve publikë 13
Tabela 7. Pozitat e lira në institucionet dhe agjencitë e pavarura 15
Tabela 8. Pozitat e lira në institucionet e pavarura të ndara sipas kategorive të pozitës 15
Tabela 9. Pozitat e lira në komuna sipas kategorisë 16
Tabela 10. Pozitat e lira në komuna të ndara sipas kategorive të pozitës 16
Tabela 11. Pozitat e lira në komuna 17
Tabela 12. Trajnimet më të shpeshta të kërkuara për stafin e punësuar 19
Tabela 13. Trajnimet më të shpeshta të kërkuara për stafin e ri 19

Shkurtesat

LZP - Ligji Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik
DMZP - Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik
DMBNjZhK - Divizioni për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore dhe Zhvillim të Kapaciteteve
SIMBNj - Sistemi Informativ për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore
MDAP - Ministria e Digjitalizimit dhe Administratës Publike
NjMBNj - Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore
IKAP - Instituti i Kosovës për Administratë Publike

1. Hyrje

Në Shtator të vitit 2023 ka hyrë në fuqi Ligji Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik (LZP). Neni 17 i këtij Ligji përcakton se çdo institucion që punëson zyrtarë publik, përgatit planin vjetor të personelit në pajtim me procesin e planifikimit buxhetor, i cili përmban nevojat për personel kompetent dhe cilësor në arritjen e misionit dhe objektivave të institucionit. Me qëllim të përcaktimit të procedurave për planifikimin e personelit, përmbajtjen e planeve dhe miratimin e planeve, si dhe përgjegjësitë e institucioneve në hartimin dhe zbatim të planeve të personelit, Ministri i Punëve të Brendshme përmes Vendimit Nr.0516/2024 të datës 20.09.2024, ka miratuar Rregulloren (MPB) 03/2024 për Planifikimin e Personelit.

Rregullorja përcakton se planet vjetore hartohen dhe vendosen në SIMBNj nga NjMBNj në bashkëpunim me njësitë organizative të institucionit dhe njësinë për buxhet dhe financa të institucionit e cila e siguron përputhjen me procesin e planifikimit buxhetor të institucionit.

Plani vjetor i personelit hartohet për të gjitha kategoritë e zyrtarëve publik dhe përmban:

- Planifikimin e nevojave të personelit që nënkupton analizën e nevojave të institucionit për të ardhmen, planifikim i cili bazohet në krahasimin e objektivave të institucionit me kapacitetet aktuale të tij, përfshirë prioritetet e institucionit dhe të Qeverisë;
- Planifikimin e rekrutimit të personelit që nënkupton planifikimin konkret për plotësimin e vendeve të lira të punës ekzistuese dhe të krijuar, si dhe afatet për plotësimin e tyre;
- Planifikimin e zhvillimit të personelit që nënkupton planifikimin e zhvillimit professional dhe ngritjes së aftësive të mëtejme të personelit;
- Planifikimin e shpenzimeve për nevojat e personelit që nënkupton planifikimin e saktë të buxhetit për nevojat e personelit, duke përfshirë personelin ekzistues, si dhe personelin që planifikohet të rekrutohet.

Ministria e Digjitalizimit dhe Administratës Publike (MDAP) harton planin vjetor të personelit për institucionet e administratës shtetërore, i cili miratohet nga Ministri i MDAP-së. Në këtë Plan të Përgjithshëm të Personelit përfshihen të dhënat e administratës shtetërore, si dhe planet vjetore të personelit të institucioneve të pavarura dhe komunave, të cilat miratohen drejtpërdrejt nga titullarët e institucioneve përkatëse. Përfshirja e këtyre planeve në një dokument të vetëm mundëson pasqyrimin e plotë të nevojave për personel në të gjithë sektorin publik.

Ky plan i përgjithshëm i personelit është i ndarë në këto pjesë:

- Pozitat e lira në të gjitha Institucionet;
- Pozitat e lira në kuadër të Institucioneve të Administratës Shtetërore;
- Pozitat e lira në kuadër të Institucioneve dhe Agjencive të Pavarura;
- Pozitat e lira në kuadër të Komunave;
- Plani i trajnimeve.

Të gjitha pozitat e parapara në këtë plan të përgjithshëm të personelit janë planifikuar të plotësohen gjatë vitit 2026. Monitorimi i zbatimit të këtij plani do të bëhet përmes raportit për menaxhimin e burimeve njerëzore që do të hartohet në fillim të vitit 2027.

Në bazë të Rregullores 03/2024, planet e personelit të miratuara vendosen në SIMBNj, më së largu deri në fund të muajit dhjetor të çdo viti për vitin pasues. Ky Plan i Përgjithshëm i Personelit për vitin 2026, përfshin të dhënat e pranuara deri më 31 dhjetor 2025 dhe bazohet në rregullimin institucional sipas Rregullores (QRK) Nr. 14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive.

Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik përmes Sistemit Informativ për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore (SIMBNJ) ka pranuar nëntëdhjetë e tetë (98) plane të personelit[1], si në vijim:

- Pesëdhjetë e një (51) plane nga institucionet e administratës shtetërore;
- Tridhjetë e pesë (35) plane të komunave; dhe
- Dymbëdhjetë (12) plane për institucionet e pavarura.

STATISTIKAT KRYESORE

5,293 Pozita të lira gjithsej	**98** Institucione	**+618** Pozita më shumë se në vitin 2025	**1,104** Pensionime të parashikuara

51 Institucione Shtetërore	**35** Komuna	**12** Institucione dhe Agjenci të Pavarura	**98** Gjithsej

Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik • **Bazuar në të dhënat e SIMBNJ**

[1] Bazuar në të dhënat e pranuara nga SIMBNJ dhe të përfshira në këtë Plan të Përgjithshëm të Personelit, nga institucionet në plan: tri nuk e kanë dërguar draftin për aprovim, 14 kanë qenë në pritje dhe një institucion është anuluar.

2. Pozitat e lira në të gjitha institucionet

Në planet e personelit për vitin 2026 që kanë dërguar nëntëdhjetë e tetë (98) institucionet në SIMBNJ, janë paraparë gjithsej 5,293 pozita të lira. Në bazë të kategorive, vendet e lira janë të ndara si në vijim:

- 2,215 vende të lira për nëpunës të shërbimit civil;
- 2,686 vende të lira nëpunës të shërbimit publik;
- 380 vende të lira për nëpunës teknik dhe mbështetës; dhe
- 12 vende të lira për krijues dhe performues të artit dhe kulturës.

Nëpunës të shërbimit civil	Nëpunës të shërbimit publik	Krijues dhe performues të artit dhe kulturës	Nëpunës teknik dhe mbështetës	Gjithsej
2,215	2,686	12	380	5,293

Tabela 1. Vendet e lira në të gjitha institucionet sipas kategorive të zyrtarëve.

Nga 5293 pozita të parapara në planet e personelit, 1104 janë parashikuar të lira për shkak të pensionimeve që do të ndodhin gjatë këtij viti, ndërsa 4189 janë të planifikuara të lira për shkak se kanë mbetur të paplotësuara në periudha të mëhershme, të rasteve tjera të përfundimeve të marrëdhënies së punës, apo krijimit të pozitave të reja.

Në bazë të nenit 5 të LZP-së, kategoritë e zyrtarëve publik janë: nëpunësit e shërbimit civil; nëpunësit e shërbimit publik; krijuesit dhe performuesit e artit dhe kulturës; nëpunësit teknik dhe mbështetës; dhe zyrtarët e kabinetit. Në mungesë të aktit nënligjor për klasifikimin e vendeve të punës për krijuesit dhe performuesit e artit dhe kulturës, pjesa më e madhe e institucioneve nuk kanë propozuar pozita për këtë kategori. Megjithatë, katër komuna (Peja, Gjakova, Gjilani dhe Deçani) kanë dërguar gjithsej 12 pozita.

	Nëpunës të shërbimit civil	Nëpunës të shërbimit publik	Krijues dhe performues të artit dhe kulturës	Nëpunës teknik dhe mbështetës	Gjithsej
Institucionet e Administratës Shtetërore	1,190	240	0	54	1,484
Institucionet e Pavarura	106	0	0	8	114
Komunat	919	2,446	12	318	3,695
Gjithsej	**2,215**	**2,686**	**12**	**380**	**5,293**

Tabela 2. Numri i pozitave të lira për zyrtarët publik në të gjitha institucionet të ndarë sipas institucioneve dhe kategorive të zyrtarëve.

Sa i përket klasifikimit të pozitave në shërbimin civil, njëzet e nëntë (29) pozita në të gjitha institucionet janë të lira në kategorinë e lartë drejtuese që përfshijnë Drejtorët e Përgjithshëm të Agjencive dhe Institucioneve të Pavarura, Sekretarët e Përgjithshëm të Ministrive, Drejtorët e Agjencive Ekzekutive dhe pozitat e barasvlershme. Në kategorinë e mesme drejtuese që përshinë drejtorët e departamenteve në ministri, agjenci të pavarura dhe ekzekutive dhe pozitat e barasvlershme janë gjashtëdhjetë e gjashtë (66) pozita të lira, ndërsa në kategorinë e ulët drejtuese që përfshinë udhëheqësit e divizioneve dhe sektorëve janë katërqind e tetë (408) pozita të lira.

Kategoria me më së shumti pozita të lira është kategoria profesionale, ku për vitin 2026 janë paraparë 1696 pozita të lira në të gjitha institucionet të cilat kanë dërguar planet e personelit. Ndërsa për kategorinë e specialistëve janë paraparë gjashtëmbëdhjetë (16) pozita të lira.

Kategoria	Administrata Shtetërore	Institucionet e Pavarura	Komuna	Numri i pozitave të lira
Kategoria e Lartë Drejtuese	26	3	-	29
Kategoria e Mesme Drejtuese	60	6	-	66
Kategoria e Ulët Drejtuese	198	19	191	408
Kategoria e Specialistëve	16	-	31	47
Kategoria Profesionale	890	78	697	1,665
Gjithsej	**1,190**	**106**	**919**	**2,215**

Tabela 3. Nëpunësit e shërbimit civil në të gjitha institucionet sipas kategorisë.

2.1 Krahasimi i pozitave të parapara për vitin 2026 me Planin e Personelit 2025

Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik (DMZP) në vitin 2025 kishte hartuar planin e përgjithshëm të personelit, i cili është miratuar nga Ministri i Punëve të Brendshme në qershor të vitit 2025. Në këtë plan ishin paraqitur të gjitha pozitat e lira në institucionet publike që kanë hartuar planet për vitin 2025. Gjatë vitit 2025, ishin paraparë në total 4675 pozita të lira dhe atë: 2564 vende të lira për nëpunës të shërbimit civil, 1827 vende të lira nëpunës të shërbimit publik dhe 284 vende të lira për nëpunës teknik dhe mbështetës.

Siç mund të shihet në tabelën më lartë, gjatë vitit 2026 janë paraparë 618 pozita më shumë sesa në vitin 2025. Gjatë vitit 2025 janë shpallur rreth 2919 procedura të rekrutimit, prej të cilave: 1384 procedura për nëpunësit e shërbimit civil, 869 për nëpunësit e shërbimit publik, 206 për nëpunës teknik dhe mbështetës, ndërsa 460 procedura me marrëdhënie kontraktuale.

Kategoria	Plani 2025	Plani 2026	Ndryshimi
Nëpunës të shërbimit civil	2,564	2,215	− 349
Nëpunës të shërbimit publik	1,827	2,686	+ 859
Nëpunës teknik dhe mbështetës	284	380	+ 96

Kategoria	Plani 2025	Plani 2026	Ndryshimi
Gjithsej	4,675	5,281	+ 606

Tabela 4. Krahasimi i pozitave të lira 2025 dhe 2026.

Siç mund të shihet në tabelën më lartë, gjatë vitit 2026 janë paraparë 606 pozita të lira (duke mos i përfshirë 12 pozita të lira në kategorinë e zyrtarëve publik krijues dhe performues të artit dhe kulturës pasi që nuk ishin të pasqyruar në Planin e Përgjithshëm të Personelit të vitit të kaluar) më shumë sesa në vitin 2025. Gjatë vitit 2025 janë shpallur rreth 2919 procedura të rekrutimit, prej të cilave: 1384 procedura për nëpunësit e shërbimit civil, 869 për nëpunësit e shërbimit publik, 206 për nëpunës teknik dhe mbështetës, ndërsa 460 procedura me marrëdhënie kontraktuale.

2.2 Profili arsimor i pozitave të lira të shërbimit civil dhe mënyra e përmbushjes së pozitave

Neni 37 paragrafi 5 i Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, përcakton se pozitat e kategorisë profesionale grupohen sipas kualifikimit dhe/apo natyrës së pozitës në:

- Grupe të administrimit të veçantë ku secili prej tyre ka pozita të ngjashme, në një apo më shumë institucione, ku kryerja me sukses e detyrave dhe përgjegjësive, kërkon njohuri dhe aftësi të posaçme që burojnë dhe lidhen me zotërimin e një apo disa profesioneve të ngjashme; dhe
- Grup i pozitave të administrimit të përgjithshëm që përfshin të gjitha pozitat që kanë të bëjnë me ushtrimin e detyrave dhe përgjegjësive të përgjithshme administrative, kryerja me sukses e të cilave kërkon njohuri dhe aftësi të përgjithshme administrative të cilat nuk lidhen me zotërimin e një ose disa profesioneve të caktuara.

Qeveria e Republikës së Kosovës më datë 27 shkurt 2024, ka miratuar Rregulloren (QRK) Nr.06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, e cila përcakton klasat për secilën kategori të shërbimit civil, emërtesat e pozitave për çdo klasë, përshkrimin e përgjithshëm për secilën kategori dhe klasë, procedurën dhe metodologjinë e klasifikimit të pozitave të punës dhe ndarjen e grupeve të administrimit të përgjithshëm dhe administrimit të veçantë në Shërbimin Civil të Kosovës.

Neni 29 i Rregullores Nr. 06/2024 përcakton se çdo pozitë pune e kategorisë profesionale dhe të specialistëve në shërbimin civil, është pjesë e një prej grupeve të përcaktuara në shtojcën 2 të Rregullores dhe se pozita klasifikohet në grupin e detajuar me të cilin korrespondon fusha e arsimit të kërkuar për atë pozitë, sipas përshkrimit të punës dhe klasën përkatëse.

Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik (DMZP) në tetor të vitit 2024 ka finalizuar Katalogun e Vendeve të Punës pas procesit të konsultimeve me të gjitha institucionet publike. Katalogu është hartuar nga grupi punues i përbërë nga DMZP, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, dhe përfaqësuesi i kolegjiumit të menaxherëve të burimeve njerëzore të Komunave. Më datë 23.10.2024 Qeveria e Republikës ka miratuar katalogun e vendeve të punës në shërbimin civil, i cili përmban 1536 pozita të kategorisë profesionale, së bashku me klasat, grupet dhe fushat e kërkuara të arsimit. Katalogu i vendeve të punës, është hartuar me qëllim të lehtësimit të klasifikimit të pozitave të punës në shërbimin civil, si rezultat ka lehtësuar punën e institucioneve edhe për hartimin e planeve të personelit. Gjatë vitit 2025 janë shtuar ose ndryshuar 14 pozita në katalogun e vendeve të punës dhe në SIMBNj sipas Vendimeve të Ministrit të MPB-së.

Nga 64 grupet e administrimit të përgjithshëm dhe të veçantë të përcaktuara në Rregulloren (QKR) Nr. 06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, në Planin e Personelit për vitin 2026

përfshin pozita nga 46 grupe të ndryshme të administrimit. Numri më i madh i pozitave të lira të kategorisë profesionale paraqitet përafërsisht në: grupin e administrimit të përgjithshëm – arsim i lartë (270), grupin e shkencave shoqërore (162) grupin ligjor (146), grupin e buxhetit dhe financave (69), grupin e teknologjisë informative (47), grupin e bujqësisë, pyjeve dhe tokës (47) dhe grupin e prokurimit publik (37). Ndërsa sa i përket kategorisë së specialistëve, numri më i madh i pozitave të lira janë paraparë nga grupi i Inxhinierisë së Ndërtimit, grupi i Gjeodezisë dhe nga grupi i Arkitekturës.

Duke marrë parasysh fushat e studimit të secilit nga grupet, profesionet më të kërkuara nga institucionet publike gjatë vitit 2026 do të jenë të diplomuarit në juridik, ekonomi dhe shkenca të tjera shoqërore. Nga të gjitha pozitat e planifikuara, institucionet publike kanë paraparë 118 pozita të shërbimit civil të kategorisë profesional 3 dhe grupit të administrimit të përgjithshëm. Për të gjitha këto pozita të kategorisë profesionale, kriteri i arsimimit do të jetë Shkolla e Mesme.

Sa i përket mënyrës së përmbushjes së pozitave të lira, duke qenë se LZP ka paraparë në nenin 7 se pranimi në detyrë i nëpunësit civil, nëpunësit të shërbimit publik, krijuesit dhe përformuesit së artit dhe kulturës, si dhe nëpunësit teknik dhe mbështetës bëhet vetëm përmes procedurave të hapura dhe konkurruese, të gjitha pozitat e parapara në këtë plan do të plotësohen përmes procedurave të hapura dhe publike. Në përputhje me nenin 6 paragrafin 3 të Rregullores (MPB) Nr. 03/2024 për Planifikimin e Personelit, institucionet gjatë planifikimit të pozitave të lira kanë përcaktuar se pesëdhjetekatër (54) pozita do të plotësohen përmes sistemimit të bursistëve të Programit "Young Cell Scheme". Ndërsa në pajtim me nenin 6 paragrafin 4 të Rregullores, njëzetetre (23) pozita do të jenë të hapura për aplikim vetëm për gjininë femërore, tridhjetepesë (35) për personat me aftësi të kufizuar dhe pesëdhjetepesë (55) për pjesëtarët e komuniteteve.

3. Pozitat e lira në kuadër të Institucioneve të Administratës Shtetërore

Vendet e lira të planifikuara për rekrutim në institucionet e administratës shtetërore gjatë vitit 2026 janë 1,484, nga të cilat 1,190 nëpunës të shërbimit civil, 240 nëpunës të shërbimit publik dhe 54 nëpunës teknik dhe mbështetës.

1,190 Nëpunës të shërbimit civil	240 Nëpunës të shërbimit publik	54 Nëpunës teknik dhe mbështetës	1,484 Gjithsej

Tabela 4 Pozitat e lira në institucionet e administratës shtetërore sipas kategorisë së

Kategoria	Numri i pozitave të lira
Kategoria e Lartë Drejtuese	26
Kategoria e Mesme Drejtuese	60
Kategoria e Ulët Drejtuese	198
Kategoria Profesionale	890
Kategoria e Specialistëve	16

Kategoria	Numri i pozitave të lira
Gjithsej	1,190

Tabela 5. Pozitat e lira të shërbimit civil në institucionet e administratës shtetërore sipas kategorisë së pozitës.

Sa i përket klasifikimit të pozitave në shërbimin civil, njëzet e gjashtë (26) pozita janë të lira në kategorinë e lartë drejtuese që përfshijnë Sekretarët e Përgjithshëm të Ministrive, Drejtorët e Agjencive Ekzekutive dhe pozitat e barasvlershme. Gjashtëdhjetë (60) pozita janë në kategorinë e mesme drejtuese që përshinë drejtorët e departamenteve në ministri dhe agjenci dhe pozitat e barasvlershme. Njëqind e nëntëdhjetë e tetë (198) janë në kategorinë e ulët drejtuese, që përfshinë udhëheqësit e divizioneve, ndërsa numri më i madh, tetëqind e nëntëdhjetë (890) pozita, janë të kategorisë profesionale.

Janë 51 Institucione të administratës shtetërore që kanë dërguar planet e personelit në SIMBNJ. Tabela e mëposhtme paraqet të dhënat e detajuara të ndara sipas institucioneve dhe kategorive.

Nr.	Emri i institucionit	Nëpunës të shërbimit civil	Nëpunës të shërbimit publik	Nëpunës teknik dhe mbështetës	Gjithsej pozita të lira
1.	Agjencia e Kosovës për Forenzikë	4	-	-	4
2.	Agjencia e Menaxhimit Emergjent	26	-	-	26
3.	Agjencia e Punësimit e Republikës së Kosovës	61	-	-	61
4.	Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë	31	-	-	31
5.	Agjencia për Ndihmë Juridike Falas	4	-	-	4
6.	Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë	29	-	3	32
7.	Agjencia Qendrore e Prokurimit	2	-	-	2
8.	Agjencia Pyjore e Kosovës	44	-	33	77
9.	Akademia e Kosovës për Siguri Publike	9	3	-	12
10.	Inspektorati Qendror i Punës	76	-	-	76
11.	Inspektorati i Arsimit të Kosovës	29	-	4	33
12.	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal	34	-	2	36
13.	Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit	29	-	-	29
14.	Agjencia e Arsimit dhe Aftësimit Profesional	-	3	-	3


Nr.	Emri i institucionit	Nëpunës të shërbimit civil	Nëpunës të shërbimit publik	Nëpunës teknik dhe mbështetës	Gjithsej pozita të lira
15.	Agjencia e Kosovës për Akreditim	3	-	-	3
16.	Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve	3	-	-	3
17.	Autoriteti i Aviacionit Civil	5	-	-	5
18.	Qendra e Studentëve	-	17	1	18
19.	Universiteti "Haxhi Zeka" në Pejë	-	5	-	5
20.	Universiteti i Gjilanit	-	25	1	26
21.	Universiteti 'Isa Boletini' në Mitrovicë	-	13	-	13
22.	Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj	-	3	-	3
23.	Universiteti i Prizrenit	-	58	-	58
24.	Instituti Pedagogjik i Kosovës	-	2	-	2
25.	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural	37	-	-	37
26.	Ministria e Drejtësisë	49	-	-	49
27.	Ministria e Ekonomisë	64	-	-	64
28.	Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve	105	-	-	105
29.	Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë	77	-	-	77
30.	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit	24	49	2	75
31.	Biblioteka Kombëtare e Kosovës 'Pjetër Bogdani'	-	15	-	15
32.	Ministria e Mbrojtjes	75	-	1	76
33.	Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës	23	-	1	24
34.	Agjencia Kadastrale e Kosovës	10	-	-	10
35.	Ministria e Punëve të Brendshme	114	-	-	114
36.	Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës	17	-	-	17
37.	Ministria e Shëndetësisë	11	-	-	11

Nr.	Emri i institucionit	Nëpunës të shërbimit civil	Nëpunës të shërbimit publik	Nëpunës teknik dhe mbështetës	Gjithsej pozita të lira
38.	Agjencia e Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale	4	-	-	4
39.	Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës	-	22	1	23
40.	Ministria e Zhvillimit Rajonal	6	-	-	6
41.	Ministria për Komunitete dhe Kthim	25	-	-	25
42.	Qendra Kombëtare e Kosovës për Transfuzionin e Gjakut	-	12	-	12
43.	Shërbimi Korrektues i Kosovës	36	-	5	41
44.	Shërbimi Sprovues i Kosovës	7	-	-	7
45.	Thesari i Kosovës	14	-	-	14
46.	Zyra e Kryeministrit të Kosovës	63	-	-	63
47.	Instituti i Krimeve të Kryera gjatë Luftës në Kosovë	8	-	-	8
48.	Agjencia e Statistikave të Kosovës	30	-	-	30
49.	Agjencia për Barazi Gjinore	2	-	-	2
50.	Instituti i Mjekësisë Ligjore	-	3	-	3
51.	Kolegji Publik Ndërkombëtar i Biznesit në Mitrovicë (IBCM)	-	10	-	10
	Gjithsej	**1,190**	**240**	**54**	**1,484**

Tabela 6. Pozitat e lira në institucionet e administratës shtetërore sipas kategorisë së zyrtarëve publikë.


3.1 Krahasimi i pozitave të parapara për vitin 2026 me Planin e Personelit 2025 për Institucionet e Administratës Shtetërore

Gjatë vitit 2025, institucionet e administratës shtetërore kishin paraparë në total 1775 pozita të lira dhe atë: 1483 vende të lira për nëpunës të shërbimit civil, 217 vende të lira nëpunës të shërbimit publik dhe 75 vende të lira për nëpunës teknik dhe mbështetës.



Pra, gjatë vitit 2026, institucionet e administratës shtetërore kanë paraparë 291 pozita të lira më pak sesa gjatë vitit 2025.

Sa i përket kategorive, përveç për kategorinë e specialistëve ku ka një rritje të lehtë të numrit të pozitave të lira, në kategoritë tjera gjatë vitit 2026 janë paraparë më pak pozita të lira se gjatë vitit 2025.



Nr.	Komuna	Nëpunës të shërbimit civil	Nëpunës të shërbimit publik	Krijues dhe performues të artit dhe kulturës	Nëpunës teknik dhe mbështetës	Gjithsej pozita të lira
10.	Istog	18	-	-	1	19
11.	Junik	11	18	-	2	31
12.	Kaçanik	14	31	-	5	50
13.	Kamenicë	33	84	-	8	125
14.	Klinë	14	38	-	5	57
15.	Leposaviq	76	225	-	75	376
16.	Lipjan	15	56	-	1	72
17.	Malishevë	25	3	-	-	28
18.	Mitrovica e Veriut	8	528	-	87	623
19.	Mitrovicë	31	110	-	2	143
20.	Novobërdë	10	30	-	-	40
21.	Obiliq	18	3	-	-	21
22.	Partesh	5	-	-	-	5
23.	Pejë	74	123	5	8	210
24.	Podujevë	29	67	-	10	106
25.	Prishtinë	40	-	-	-	40
26.	Rahovec	41	51	-	4	96
27.	Ranillugë	4	-	-	-	4
28.	Shtërpcë	12	-	-	-	12
29.	Shtime	17	45	-	1	63
30.	Skenderaj	69	68	-	12	149
31.	Suharekë	10	59	-	8	77
32.	Viti	10	54	-	6	70
33.	Vushtrri	20	65	-	-	85
34.	Zubin Potok	48	14	-	13	75
35.	Zveçan	66	26	-	10	102
	Gjithsej	**919**	**2,446**	**12**	**318**	**3,695**

Tabela 11. Pozitat e lira në Komuna.

6. Plani i trajnimeve

Ligji për Zyrtarët Publik në nenin 17 (3), ndër të tjera--- fjalija me ngjyr te verdh te hiqet, Neni 17, paragrafi 3 i Ligjit për Zyrtarët Publikë, ndër të tjera, përcakton se plani vjetor i personelit duhet të përmbajë edhe nevojat për zhvillimin profesional dhe trajnim të stafit ekzistues. Obligimi i institucioneve për identifikimin dhe vlerësimin e nevojave për trajnim të nëpunësve civilë është përcaktuar edhe në nenin 16 të këtij ligji, me qëllim të sigurimit të ngritjes së kapaciteteve profesionale përmes trajnimeve të vazhdueshme.

Po ashtu, në nenin 26 është paraparë e drejta e zyrtarëve publik për aftësim profesional, duke u mundësuar zhvillimin e aftësive dhe njohurive përmes trajnimeve të financuara nga fondet publike, donatorët apo burime të tjera të lejuara. Ndërkohë, neni 34 përcakton edhe detyrimin për zhvillim profesional të vazhdueshëm për të gjithë nëpunësit civilë dhe nëpunësit e shërbimit publik.

Në planet e personelit të dërguara nga institucionet për vitin 2026, është evidentuar një gamë e gjerë e nevojave për trajnime, e cila pasqyron kërkesat për zhvillim profesional si të stafit ekzistues, ashtu edhe të stafit të ri. Kërkesat tregojnë një fokus të theksuar në përmirësimin e performancës institucionale, forcimin e kapaciteteve menaxheriale dhe administrative, si dhe avancimin e aftësive teknologjike dhe profesionale.

Gjatë analizimit të këtyre kërkesave, është vërejtur se për stafin ekzistues, nevojat për trajnim lidhen kryesisht me përmirësimin e cilësisë dhe efikasitetit të ofrimit të shërbimeve publike, zbatimin e legjislacionit në fuqi, si dhe zhvillimin e aftësive në fusha specifike profesionale dhe menaxheriale. Në anën tjetër, për stafin e ri, theksi kryesor është në trajnime hyrëse dhe orientuese, të cilat synojnë lehtësimin e integrimit në institucion, ndërtimin e njohurive bazike mbi legjislacionin dhe procedurat administrative, si dhe zhvillimin e shkathtësive themelore për ushtrimin e detyrave të punës.

Në këtë kontekst, temat më të shpeshta të trajnimeve të identifikuara si të nevojshme nga institucionet për vitin 2026, ndahen në dy kategori kryesore përmes tabelave si vijon:

Trajnimet më të shpeshta të kërkuara për stafin e punësuar

Nr.	Emri i trajnimit	Kërkesa
1	Performanca në zhvillimin e funksioneve/shërbimeve publike komunale	35
2	Mbrojtja e të dhënave personale	26
3	Hartimi dhe zbatimi i strategjive sektoriale	24
4	Procedura e përgjithshme administrative — trajnim i thelluar	21
5	Microsoft PowerPoint & Outlook 2021	19
6	Konflikti i interesit dhe integriteti	19
7	Administratë dhe legjislacion	16
8	Fuqizimi i udhëheqjes dhe koordinimit institucional qendror	14
9	Planifikimi dhe programimi buxhetor lokal (vjetor dhe afatmesëm)	14

Nr.	Emri i trajnimit	Kërkesa
10	Trajnime për Ligje dhe Rregullore	14
11	Bashkimi evropian, institucionet dhe roli i tij	14
12	Menaxhimi i pronës Komunale	12
13	Disiplina dhe ankimimi në shërbimin civil	11
14	Buxhet dhe Financa	11
15	Microsoft Excel 2021	11

Tabela 12. Trajnimet më të shpeshta të kërkuara për stafin e punësuar.

Trajnimet më të shpeshta të kërkuara për stafin e ri

Nr.	Emri i trajnimit	Kërkesa
1	Trajnimi hyrës për nëpunësit e rinj të shërbimit civil	198
2	Trajnime nga IKAP sipas kalendarit të trajnimeve	21
3	Trajnim për legjislacionin	12
4	Integriteti dhe etika (konflikti i interesit, anti-korrupsion)	10
5	Menaxhimi i financave publike	9
6	Procedurat e përgjithshme administrative	9
7	Administrimi i punës në zyrë	7
8	Arkivimi dhe ruajtja e dokumenteve	6
9	Bazat e të dhënave	4
10	Komunikimi me publikun	4
11	PowerPoint	3
12	Puna ekipore dhe motivimi i punonjësve	3
13	Menaxhimi i burimeve njerëzore	2
14	Menaxhimi i kontratës përmes e-prokurimit	2
15	Planifikimi dhe programimi buxhetor lokal (vjetor dhe afatmesëm)	2

Tabela 13. Trajnimet më të shpeshta të kërkuara për stafin e ri.

Këto të dhëna tregojnë një qasje të strukturuar të institucioneve drejt zhvillimit profesional, ku për stafin ekzistues theksi vendoset në avancimin e kompetencave dhe rritjen e performancës institucionale, ndërsa për stafin e ri, prioritet mbetet ndërtimi i bazës profesionale dhe integrimi efektiv në shërbimin civil. Trajnimet e identifikuara përbëjnë bazë për planifikimin dhe prioritizimin e zhvillimit profesional.

7. Përfundim

Plani i Përgjithshëm i Personelit për vitin 2026, është hartuar në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Ligjin Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik dhe Rregulloren (MPB) Nr. 03/2024 për Planifikimin e Personelit. Ky plan është hartuar duke u bazuar në të dhënat e njësive për menaxhimin e burimeve njerëzore në sektorin publik, duke pasqyruar nevojat e institucioneve për plotësimin e pozitave të lira dhe zhvillimin profesional të stafit ekzistues.

Me gjithë sfidat e zbatimit të kornizës së re ligjore dhe përshtatjes së SIMBNj-së, bashkëpunimi me institucionet e administratës shtetërore, agjencitë dhe institucionet e pavarura, si dhe me nivelin komunal, ka mundësuar hartimin e një plani të balancuar dhe të harmonizuar me objektivat funksionale dhe buxhetore të secilit institucion.

Zbatimi i këtij plani do të ndihmojë në forcimin e kapaciteteve njerëzore në administratën publike, duke kontribuuar kështu në përmirësimin e efikasitetit institucional, rritjen e transparencës në rekrutim dhe sigurimin e zhvillimit të vazhdueshëm profesional. DMZP kryen monitorimin dhe raportimin mbi zbatimin e tij, i cili realizohet përmes SIMBNj-së dhe do të evidentohet në raportin për menaxhimin e burimeve njerëzore në fillim të vitit 2027.

Plani do të shërbejë si bazë për zhvillimin e procedurave të rekrutimit dhe përpjekjet e zhvillimit të mëtejshëm të burimeve njerëzore në përputhje me objektivat strategjike të Qeverisë dhe standardet e shërbimit civil.

01	02	03
Forcimi i kapaciteteve njerëzore	**Transparencë në rekrutim**	**Zhvillim i vazhdueshëm profesional**
5,293 pozita të lira të planifikuara për plotësim do të kontribuojnë drejtpërdrejt në efikasitetin institucional të Kosovës.	Të gjitha pozitat do të plotësohen përmes procedurave të hapura dhe publike, sipas LZP-së.	Planet e trajnimeve sigurojnë ngritje të kapaciteteve si të stafit ekzistues ashtu edhe të ri.